



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 27 dhjetor 2018
Nr. ref.:RK 1310/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI68/18

Parashtrues

Asllan Veseli

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 175/2017, të 29 janarit 2017, Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 22/ 2017, të 23 shkurtit 2018 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, P. nr. 230/2015, të 3 nëntorit 2016.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Asllan Veseli, nga fshati Greme, komuna e Ferizajt (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Fehmije Gashi-Bytyqi, avokate nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 175/2017, të 29 janarit 2018, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 22/2017, të 23 shkurtit 2017 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, P. nr. 230/2015, të 3 nëntorit 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të kontestuara, me të cilat pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31, paragrafi 4 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 10 maj 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 18 maj 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesuesi), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
8. Më 8 qershor 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
10. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi për mandat prej 9 (nëntë) vite.

11. Më 11 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin e ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Selvete Gërzhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
12. Më 29 tetor 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 15 dhjetor 2015, Prokuroria e Shtetit në Prizren – Departamenti për krime të rënda (në tekstin e mëtejshëm: Prokuroria e Shtetit), ngriti aktakuzë [PP. nr. 206/15] kundër parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Themelore - Departamenti për krime të rënda (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore), për shkak të veprës penale fajdeja, nga neni 343, paragrafi 3, në lidhje me paragrafin 1 të Kodit Penal (në tekstin e mëtejshëm: KP), veprës penale kanosja, nga neni 185, paragrafi 2, i KP-së dhe veprës penale detyrimi, nga neni 340, paragrafi 2, në lidhje me paragrafin 1 të KP-së.
14. Më 3 nëntor 2016, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin P. nr. 230/15, me të cilin parashtruesin e kërkesës e shpalli fajtor për kryerjen e të gjitha veprave penale nga aktakuza dhe e dënoi me dënim unik të burgimit me kohëzgjatje prej 7 (shtatë) viteve, si dhe me gjobë në shumë prej 8.500 euro.
15. Në arsyetimin e aktgjykimit, Gjykata Themelore theksoi:

“Konform nenit 343 të KP-së, kushdo që për vete apo për personin tjetër pranon ose kontraktin një shumë dukshëm proporcionale të pasurisë në këmbim të shërbimit për personin tjetër, duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë personale të personit të tillë, gjendjen e rëndë të banimit, varfërinë, papërvojën ose paaftësinë për të gjykuar, për çka do të dënohet me gjobë dhe me burgim prej 6 muaj deri në 5 vjet.

[...]

Në rastin konkret këtu i akuzuari (parashtruesi i kërkesës), duke e shfrytëzuar gjendjen e rëndë personale të dëmtuarve, iu huazon shuma të të hollave me kamatë prej 10% dhe 12%.

[...]

Andaj, duke i pasur parasysh faktet e lartcekura gjykata edhe ka vërtetuar se në veprimet e këtu të akuzuarit (parashtruesit), formohen elementet qenësore të veprës penale nga neni 343, par. 3, lidhur me par. 1 të KP-së, ... nga neni 185, paragrafi 2 i KP-së, ... nga neni 340, paragrafi 2, lidhur me nenin 1 të KP-së [...].
16. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të “[...] shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, nënparagrafi 1.8, me arsyetim se i njëjti bazohet në prova të papranueshme ngase i njëjti mbështetet në dëshmitë e dëshmitarëve, ndërsa gjykata nuk lejoi marrjen në pyetje avokatin N. E. nga Prizreni, të cilin e ka propozuar i dëmtuari”.

17. Prokuroria e Shtetit, gjithashtu, paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore.
18. Më 23 shkurt 2017, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin PAKR. nr. 22/ 17, me të cilin e aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës, sa i përket cilësimit ligjor të veprave penale dhe vendimit për dënimin, me ç'rast dënimin me burgim të parashtruesit të kërkesës e zvogëloi nga 7 vjet në 5, ndërsa gjobën e zvogëloi nga 8.500 euro në 8.000.
19. Në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, theksohet:

“Gjykata e Apelit e Kosovës duke vlerësuar pretendimet ankimore të mbrojtëses së të akuzuarit lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale konstaton se pretendimet e mësipërme ankimore nuk qëndrojnë. Aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe konkret.

Gjithashtu edhe sa i përket pretendimit ankimor lidhur me shkeljen e parimit të barazisë së palëve neni 7, par. 2 i KPRK-së edhe ky pretendim ankimor nuk është i bazuar ngase Gjykata e shkallës së parë nuk e ka gjetur të arsyeshme që ta dëgjojë Nexhat Elshanin në cilësinë e dëshmitarit nga arsyeja se i njëjti ka qenë vetëm hartues i marrëveshjes së datës 08/07/2015 të përpiluar në mes të dëmtuarit dhe të akuzuarit, e të cilën marrëveshje gjykata e shkallës së parë e ka administruar si provë dhe e ka lexuar përmbajtjen e saj, në të cilën hartuesi i marrëveshjes vetëm i ka shënuar fjalët e tani të akuzuarit (parashtruesit të kërkesës) dhe të dëmtuarit”.

20. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, duke theksuar se aktgjykimet e kontestuar janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1, në lidhje me nenin 370 të KPP-së, sepse:

i) *“dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me vetveten dhe me arsyetimin,*

ii) *aktgjykimi i shkallës së parë mbështetet në deklaratat e dëshmitarëve L. Sh. dhe L. B., të cilat ndryshojnë nga ato të dhëna në procedurën parapenale,*

iii) *është shkelur neni 7, par. 2 i KPPK, për faktin se gjykata ka dhënë rëndësi vendimtare provave të ofruara nga Prokurori, ndërsa ka refuzuar provat e mbrojtjes për dëgjimin e dëshmitarit av. N. E., me çfarë shkelet barazia e palëve në procedurë”.*

21. Më 18 korrik 2017, Prokuroria e Shtetit, me Parashtrësën KMLP. II. nr. 122/2017, u përgjigj në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruesit dhe propozoi që kërkesa e tij të refuzohet si e pabazuar.

22. Më 29 janar 2018, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Pml. nr. 175/2017, me të cilin kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit e refuzoi si të pabazuar me arsyetimin:

i) *“Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i qartë dhe konkret, i njëjti përmban të gjitha elementet e parapara ligjore, kohën, mënyrën dhe vendin e kryerjes së veprave penale. Nuk ka kundërthënie me vetveten dhe me arsyetimin. Në arsyetimin e të dy aktgjykimeve të kundërshtuara, janë dhënë arsye të hollësishme faktike dhe juridike, ndërsa në atë të shkallës së dytë edhe arsyet lidhur me ricilësimin juridik të veprave penale,*

ii) *Pretendimin e dytë të parashtruesit të kërkesës, kjo gjykatë e vlerëson si të pabazuar, sepse deklaratat e dëshmitarëve janë marrë në mënyrë ligjore, ndërsa fakti se ato ndryshojnë në fazat e ndryshme të procedurës të njëjtat nuk e bëjnë të papranueshme. [...] ato janë vlerësuar në harmoni me ligjin kështu që mbrojtja mund të kundërshtoj kredibilitetin e këtyre dëshmiave por jo edhe pranueshmërinë.*

iii) *Nuk është i bazuar pretendimi se në rastin konkret gjykata ka shkelur parimin e barazisë së palëve në procedurë kur është refuzuar propozimi i mbrojtjes për dëgjimin e dëshmitarit avokatit Nexhat Elshani. Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur ka refuzuar propozimin në fjalë, për faktin se në këtë çështje penale dëshmia e këtij dëshmitari do të ishte irrelevante, ... dhe kjo për arsye se ai vetëm e ka përpiluar një dokument me shkrim”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimet e kontestuarat i janë shkelur të drejtat dhe liritë të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31, paragrafi 4 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.
24. Parashtruesi i kërkesës para së gjithash pretendon shkeljen e së drejtës të garantuar me nenin 31.4 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], sepse gjykatat e rregullta nuk lejuan dëgjimin e dëshmitarit të cilin e propozoi mbrojtja, me çka, sipas pretendimeve të parashtruesit, atij i është shkelur e drejta për barazinë e palëve në procedurë.
25. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese që t'i anulojë aktgjykimet e gjykatave të rregullta dhe çështjen ta kthej në rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

28. Gjykata më tej shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë, siç janë përcaktuar me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

29. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafi 2, të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

30. Sa i përket plotësimit të këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi ka paraqitur kërkesë në cilësinë e palës së autorizuar, duke kontestuar aktin e autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 175/2017, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu theksoi të drejtat dhe liritë që pretendon se janë shkelur, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe ka parashtruar kërkesën në pajtim me afatin e paraparë në nenin 49 të Ligjit.
31. Gjykata së pari vëren se parashtruesi i kërkesës pretendimin për shkeljen e nenit 31, paragrafi 4 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, e lidh me faktin se gjykatat e rregullta nuk e aprovuan kërkesën e tij për të dëgjuar një person të cilin ai e ka propozuar si dëshmitar.
32. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se neni 31, paragrafi 4 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, përcakton:

“4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t’u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet. [...]”

33. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i është referuar edhe nenit 6, të KEDNJ-së, por nga pretendimet e tij në fakt rrjedh se ai konsideron se nuk ka pasur një proces të rregullt sepse nuk u respektuan garancitë në kuptim të nenit 6, paragrafi 3, pika d) të KEDNJ-së.

34. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se neni 6.1, paragrafi 3, pika d) (E drejta për një proces të rregullt) i KEDNJ-së përcakton:

1. “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj.

[...]

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

[...]

d) të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

35. Gjykata, duke marrë parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës që tregojnë se e drejta për gjykim të drejtë i është shkelur për shkak të refuzimit të dëshmimeve të tij për të dëgjuar dëshmitarin, thekson se neni 6 i KEDNJ-së nuk garanton të drejtën që të gjitha provat e propozuara nga paneli duhet të jenë të pranueshme. Gjithashtu, e drejta për një gjykim të drejtë nuk kërkon që të ndiqet ndonjë rregull i posaçëm në vlerësimin e provave në gjykatat penale. (shih, *inter alia*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, i 6 dhjetorit 1988. Seria A, nr. 146, pika 68).

36. Gjithashtu, Gjykata rikujton praktikën e GJEDNJ-së, sipas të cilës neni 6, paragrafi 3, i KEDNJ-së kërkon që gjykata vetëm t’i cekë arsyet për të cilat ka vendosur të mos zbatojë provat e propozuara, të cilat i akuzuari (parashtruesi i kërkesës) e ka kërkuar në mënyrë eksplicite (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Vidal kundër Belgjikës*, të 22 prillit 1992, Seria A, nr. 235, pika 34).

37. Duke pasur parasysh qëndrimet e lartpërmendura në lidhje me faktet e rastit konkret, Gjykata vëren se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit lidhur me propozimin e parashtruesit për të dëgjuar një person, përkatësisht një avokat si dëshmitar, në mënyrë të qartë dhe të argumentuar theksuan se e përjashtojnë mundësinë që dëshmitari i propozuar mund të ndryshojë faktet të cilat kanë të bëjnë me vetë aktin e kryerjes së veprës penale. Kjo sepse roli i tij ishte vetëm përpilimi i një dokumenti, të cilin e bëri me kërkesën e parashtruesit, me ç’rast dëshmia e tij nuk do të ndikonte dhe ndryshonte gjendjen faktike në lidhje me faktet vendimtare për ekzistimin e veprës penale, të cilat ishin vërtetuar në procedurën e provave, si në provat ashtu edhe në dëgjimin e palës së dëmtuar.

38. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka trajtuar çështjen e barazisë së palëve në procedurë dhe konkludoi se “*paraqitja e dëshmisë në fjalë nuk ishte e nevojshme*”, duke ofruar arsyetim të gjerë ligjor për qëndrim të tillë, të cilin kjo Gjykatë nuk e konsideron të parregullt, arbitrar ose diskriminues, dhe që do të ishte në dëm të parashtruesit të kërkesës.
39. Bazuar në atë që u tha më sipër, Gjykata konsideron se barazia e palëve nuk është vënë në pyetje në rastin konkret, pasi që nga aktgjykimet e kontestuar rezultoi se gjykatat e kanë trajtuar çështjen për të cilën parashtruesi konsideron se ka shkaktuar shkelje të parimit të barazisë së palëve në procedurë për çka ata kanë dhënë edhe arsye të mjaft të përgjithshme në aktgjykimet e tyre.
40. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se gjykatat e rregullta kanë respektuar detyrën e tyre sipas nenit 31, paragrafi 4 të Kushtetutës dhe nenit 6, paragrafi 3 d) të KEDNJ-së, prandaj pretendimet e parashtruesit se me vendimet e kontestuar është shkelur e drejta për gjykim të drejtë në atë segment janë të pabazuara.
41. Gjykata konsideron se asgjë në rastin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës nuk tregon se procedura në gjykatat e rregullta ishte e padrejtë dhe arbitrare, në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të bindet se parashtruesit të kërkesës i ishte mohuar ndonjë garanci procedurale që do të rezultonte në shkelje të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, përkatësisht nenin 6 të KEDNJ-së.
42. Sa i përket pretendimeve të tjera të parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljen e të drejtave dhe lirive të garantuara me nenin 24 [Barazia para ligjit] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, Gjykata këto pretendime i konsideron si të pabazuara, dhe kjo vetëm për faktin se parashtruesi nuk ka dëshmuar dhe mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij.
43. Gjykata thekson se është obligim i parashtruesit të kërkesës që të mbështet pretendimet e tij kushtetuese dhe të paraqet dëshmi *prima facie* që tregon shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih: rasti i Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylaj*, të 5 dhjetorit 2013).
44. Prandaj, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113. 1 dhe 7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 29 tetor 2018, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Artë Rama-Hajrizi